

VENDIM
Nr. 173, datë 3.8.2018

MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “MP-HEC” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NIÇË”, ME FUQI TË INSTALUAR 1.668 mw, ME VENDNDODHJE NË KOMUNËN GORË, RRETHI KORÇË

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 41, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 13, pika 2, germa “a” dhe nenit 14 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për refuzimin e kërkesës së shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë nga HEC “Niçe”, me fuqi të instaluar 1.668 mw, me vendndodhje në komunën Gorë, rrethi Korçë,

konstatoi se:

- Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 286 prot., datë 28.3.2018, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçe”, me fuqi të instaluar 1.668 mw, me vendndodhje në komunën Gorë, rrethi Korçë.

- ERE-s vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçe”, me fuqi të instaluar 1.668 mw, me fuqi të instaluar 1.668 mw, me vendndodhje në komunën Gorë, rrethi Korçë, për një afat 26-vjeçar.

- Në lidhje me mungesën e konstatuar të dokumentacionit, që ka të bëjë me nenin 9, pika 4.1.4 (Miratimi i projektit të zbatimit), nëpërmjet shkresës së ERE nr. 286/1 prot., datë 26.4.2018, u njoftua subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

- ERE, me shkresën nr. 286/3 prot., datë 14.5.2018, ka përsëritur kërkesën për plotësim dokumentacioni.

- Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. është përgjigjur me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 286/4 prot., datë 15. 5.2018, me anë të së cilës ka kërkuar nga ERE shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit për arsye se subjekti është në pritje të veprimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues në lidhje me miratimin përfundimtar të projektit të zbatimit të përmirësuar.

- Bordi i ERE-s në mbledhjen e datës 4.6.2018, shqyrtoi kërkesën e subjektit për të shtyrë afatin e vendimmarrjes me 30 ditë pune në zbatim të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- ERE me shkresën nr. 286/6 prot., datë 18.

6.2018 “Njoftim”, i është drejtuar subjektit “MP-HEC” sh.p.k. duke i bërë me dije se kërkesa u pranua duke e shtyrë afatin me 30 ditë.

- Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 286/8 prot., datë 10.7.2018, ka përcjellë sqarime mbi statusin e marrjes së miratimit përfundimtar të projektit të zbatimit të përmirësuar, nga Autoriteti Kontraktues.

Shoqëria ka ridorëzuar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dokumentacionin e kërkuar për kohën kur është kryer opoenca teknike mbi projektin e zbatimit nga AKBN-ja, por ende nuk ka marrë përgjigje nga Autoriteti Kontraktues, lidhur me miratimin formal të projektit të përmirësuar.

- Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. thekson se afati i shqyrtimit të kërkesës ka përfunduar dhe referuar legjislacionit në fuqi, kërkesa konsiderohet e “miratuar në heshtje”.

- ERE gjykon se për nga rëndësia që ka për licencimin e kësaj shoqërie, Miratimi i projektit të zbatimit të përmirësuar nga organi i caktuar me ligj, duhet të depozitohet në ERE sipas formës së kërkuar nga rregullorja e licencimit, në mënyrë që të gjykohet më konkretisht mbi përmbajtjen e tij në lidhje me ndryshimet që ky miratim i bën projektit të zbatimit.

- ERE gjykon se për projektin fillestar të zbatimit me një fuqi të instaluar 660 kw, miratuar nga ministria përgjegjëse me kontratën e koncensionit nr. 311 rep, nr. 45 kol, datë 2.2.2009, shoqëria “MP-HEC” sh.p.k., në bazë të nenit 37, pika 6, germa “b”), të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nuk ka detyrim të aplikojë në ERE për pajisje me licencë.

Aplikimi i shoqërisë “MP-HEC sh.p.k., nuk plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, dhe 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Mungesa e konstatuar e dokumentacionit, ka të bëjë me nenin 9, pika 4.1.4 (Miratimin e projektit të zbatimit).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, me fuqi të instaluar 1.668 mw, me vendndodhje në komunën Gorë, rrethi Korçë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti